

**Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

|         |                                                                                                                               |
|---------|-------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| TITULLI | Interneti “dominon” shtëpitë shqiptare - AKEP: Rritet numri i abonimeve për Wi-Fi, ndërsa telefonja tradicionale vijon rënien |
| ADRESA  | https://scantv.al/lajme/shqiperia/interneti-dominon-shtepite-shqiptare--rritet-numri-i-abonime-i33283                         |
| BURIMI  | scantv.al                                                                                                                     |
| GJENDJA | edited                                                                                                                        |

## KOHA


|                       |                                                                                                                                                          |
|-----------------------|----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| KAPUR NGA NE          | 6 shtator 2026, 16:27:36 UTC<br><i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>                            |
| DEKLARUAR NGA PORTALI | 4 shtator 2026, 11:07:00 UTC<br><i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i> |

## HASH-ET · SHA-256

|            |                                                                  |
|------------|------------------------------------------------------------------|
| PËRMBAJTJA | 8cb071314bf8d5b1223d852694d90cdd7e073de6d1061d0d648b5a471efc84d1 |
| TEKSTI     | 877ac178e14a6b0874e25de4a760d059fca0e1da918e78f0913d0f4b47f32b94 |
| PAMJA      | 07b76e99b18e0502bb9d24ccd5d1e189d299388b2e3f2a5f5e523f5866fb50ae |

## ZINXHIRI I PROVËS

|               |                                                                    |
|---------------|--------------------------------------------------------------------|
| KJO HYRJE     | 92ec7ef186921cc2a79e0fd1b5e1f099d568e6f8efe141ba7d4effb40281d0b3   |
| E MËPARSHMJA  | —                                                                  |
| RRËNJA MERKLE | cae791e3aa00c35889555c700c23f70e42f4133ad0851613176cd0c76c652be7   |
| ANKORUAR      | Polygon PoS · bllok 47086362                                       |
| TRANSAKSIONI  | 0x311244189763d8704b23b9152a8422dd79e30a90c1264d1757967b7d25d9e1d2 |
| IPFS          | QmaTJq3d3L2Lnk9ysZtPZfH9yq1NEa5sUsFa8GtiZPGAjo                     |



## SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/92ec7ef186921cc2a79e0fd1b5e1f099d568e6f8efe141ba7d4effb40281d0b3>

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored · dritarja 1280×1024 px



[Karriera](#) [Kontakt](#)

[English](#)

- [Lajme](#)
- [Scan Intel](#)
- [Analiza](#)
- [Dossier](#)
- [Scan Life](#)
- [Emisionet](#)

[English](#)

Created and monetized by [mediadesk](#)

[Live TV](#)

**Tregjet**

S&P 500  
7718,6  
0,38%  
Nasdaq  
26506,99  
0,29%  
10-Yr Bond  
4,78  
0,46%  
FTSE 100  
10831,09  
0%  
Crude Oil  
91,48  
0%  
Gold  
4476,6  
0%  
EUR/USD  
1,16  
0%



[Shqipëria](#) Postuar më 4 Shtator 2026, 13:07

## Interneti “dominon” shtëpitë shqiptare - AKEP: Rritet numri i abonimeve për Wi-Fi, ndërsa telefonia tradicionale vijon rënien

Nga Ledina Elezi



Interneti “dominon” shtëpitë shqiptare - AKEP: Rritet

Interneti përmes rrjeteve fikse po fiton gjithnjë e më shumë përdorues në Shqipëri, ndërsa telefonia fikse vijon të humbasë terren. Të dhënat më të fundit të Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare tregojnë se numri i pajtimtarëve me akses broadband në internet përmes rrjeteve fikse arriti në rreth 733 mijë në tremujorin e dytë të vitit.

Kjo tregon se interneti është tashmë një shërbim gjithnjë e më i rëndësishëm për familjet dhe bizneset shqiptare. Numri i përdoruesve është rritur krahasuar me fillimin e vitit dhe me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar.

Por ndryshimi nuk është vetëm te numri i përdoruesve. Ai vihet re edhe në mënyrën se si qytetarët zgjedhin paketat e komunikimit. Gjithnjë e më shumë njerëz po zgjedhin internetin në shtëpi ose biznes, pa e lidhur domosdoshmërisht me shërbime të tjera. Në tremujorin e dytë, rreth 437 mijë pajtimtarë kishin vetëm shërbimin e internetit.

Ndërkohë, rreth 295 mijë përdorues kishin paketa të integruara, ku interneti shoqërohet me televizionin ose telefoninë. Mes këtyre paketave, më e preferuara është ajo që kombinon internetin me televizionin. Në të kundërt, paketat që përfshijnë edhe telefoninë po humbasin gradualisht përdorues.

Kjo priirje tregon një ndryshim në mënyrën se si shqiptarët komunikojnë dhe konsumojnë shërbimet dixhitale. Për shumë familje, interneti është bërë shërbimi kryesor, ndërsa telefonia tradicionale nuk shihet më si një domosdoshmëri.

Këtë e konfirmojnë edhe të dhënat për telefoninë fikse. Numri i pajtimtarëve ka zbritur në rreth 144 mijë, duke vijuar rënien edhe gjatë këtij viti. Në një kohë kur telefonatat mund të kryhen përmes aplikacioneve dhe komunikimi bëhet gjithnjë e më shumë online, përdorimi i telefonit tradicional në shtëpi po zvogëlohet.

Pra, tregu i komunikimeve po ndryshon gradualisht, interneti po zgjerohet, ndërsa telefonia fikse po tkurret. Për qytetarët kjo do të thotë se shërbimet online po marrin një rol gjithnjë e më të madh në komunikimin dhe jetën e përditshme.



Shqipëria 4 Shtator Diamila Leka

### **Si do të mbahen punonjësit e turizmit gjatë gjithë vitit? - Topuzi: Subvencion deri në 4 paga, synohet rikthimi i emigrantëve**

Zgjatja e sezonit turistik përtej muajve të verës mbetet një nga sfidat kryesore për sektorin e turizmit. Përtej nevojës për të shtuar aktivitetin gjatë.....



Shqipëria 4 Shtator Ola Mitre

### **Plane të reja për transportin e qëndrueshëm/ Nyjet urbane TEN-T duhet t'i miratojnë deri në fund të 2027-ës**

Qytetet shqiptare që do të përcaktohen si nyje urbane të rrjetit trans-evropian të transportit do të duhet të hartojnë dhe miratojnë Planet e Qëndrueshme të.....



Shqipëria 4 Shtator Elisabeta Dosku

### **Bizneseve u kthehen në llogari 82 milionë euro TVSH - Shtatë mujori/ Qershori regjistron shifrën më të lartë, ulet koha e përpunimit të kërkesave**

Bizneset kanë marrë mbrapsht përmes procesit të rimbursimit të TVSH-së rreth 7.6 miliardë lekë apo 82 milionë euro në 7 muaj. E ndarë sipas muajve, vihet re.....



Analiza 4 Shtator Xhorxhina Deda

### **Importet kushtojnë më pak në tremujorin e dytë/ Çmimet pothuajse të pandryshuara, rënia më e fortë te energjia**

Çmimet e produkteve industriale të importuara kanë vijuar të mbeten të qëndrueshme në tremujorin e dytë të vitit 2026, duke shënuar një rënie të lehtë në.....



Analiza 4 Shtator Xhorxhina Deda

### **Çmimet e prodhimit rriten lehtë/ Tregu vendas shtrenjtohet, eksportet kushtojnë më pak**

Çmimet e prodhimit në ekonomi kanë shënuar vetëm një rritje të lehtë në tremujorin e dytë të vitit 2026. Sipas INSTAT, Indeksi i Çmimeve të Prodhimit arriti.....



Shqipëria 4 Shtator Ledina Elezi

### **Rikthehet Panairi i Produkteve Artizanale në Green Coast/ “DUART”, një mbrëmje kushtuar artit dhe mjeshhtërisë**

Panairi i Produkteve Artizanale është rikthyer për të katërtin vit radhazi në Green Coast, këtë herë nën konceptin “DUART”, që vendos në qendër punën e.....



Bota 4 Shtator Lidion Kulla

### **Volkswagen do të shkurtojë 100.000 vende pune/ Ristrukturimi më i madh i ndodhur ndonjëherë në industrinë e automjeteve**

Kompania Volkswagen është gati të pushojë nga puna 1 në 7 prej punëtorëve të saj. Gjigandi gjerman i makinave njoftoi se drejtuesit e kompanisë dhe.....



Shqipëria 4 Shtator Elisabeta Dosku

### **Në 19 vite, 285 mijë qytetarë legalizuan shtëpitë/ Refuzohen 6 mijë aplikime. Procesi përfundon në 2028-ën**

Pavarësisht se ka vite që ka nisur, procesi i legalizimit të ndërtimeve informale konsiderohet si një proces kompleks dhe afatgjatë, i kushtëzuar nga numri i.....

## Live TV

 Të fundit

Analiza 5 Shtator scan

### [Francis Fukuyama: Inteligjenca artificiale dhe ana e keqe për demokracinë](#)

Francis Fukuyama nuk ka frikë ta pranojë kur ka ndryshuar mendje. Teoricieni politik dhe profesori i Universitetit Stanford ka ndryshuar herë pas here gjatë.....

Shqipëria 5 Shtator Scan TV

### [Rama nga Cernobbio: Integrimi gradual, rruga e Shqipërisë drejt BE-së](#)

Kryeministri Edi Rama, i pranishëm në Forumin e Cernobbios në Itali, ka folur për perspektivën europiane të Shqipërisë dhe mënyrën se si vendi mund të.....

Europa 5 Shtator Scan TV

### [A po merr fund recesioni ekonomik gjerman? Ekonomia e Gjermanisë shënon shifrat më të mira në vite](#)

Ekonomia gjermane po tregon shenjat e para të një rimëkëmbjeje pas një periudhe të gjatë stanjacioni. Ekonomia më e madhe e Evropës po shkon drejt rritjes.....

Europa 5 Shtator Scan TV

### [Karburantet çmime rekord, pavarësisht naftës bruto/ Në Europë kostot ndikohen nga kapacitetet e rafinimit](#)

Perspektiva e paqes midis Iranit dhe SHBA-së i ka çuar çmimet e naftës ndjeshëm lart e poshtë në muajt e fundit. Nafta e papërpunuar Brent, standardi.....

[Të gjitha lajmet](#)

## Më të vizituarat



Analiza 5 Shtator scan

### [Francis Fukuyama: Inteligjenca artificiale dhe ana e keqe për demokracinë](#)

Francis Fukuyama nuk ka frikë ta pranojë kur ka ndryshuar mendje. Teoricieni politik dhe profesori i Universitetit Stanford ka ndryshuar herë pas here gjatë.....



Shqipëria 5 Shtator Scan TV

### [Rama nga Cernobbio: Integrimi gradual, rruga e Shqipërisë drejt BE-së](#)

Kryeministri Edi Rama, i pranishëm në Forumin e Cernobbios në Itali, ka folur për perspektivën europiane të Shqipërisë dhe mënyrën se si vendi mund të.....



Europa 5 Shtator Scan TV

### [A po merr fund recesioni ekonomik gjerman? Ekonomia e Gjermanisë shënon shifrat më të mira në vite](#)

Ekonomia gjermane po tregon shenjat e para të një rimëkëmbjeje pas një periudhe të gjatë stanjacioni. Ekonomia më e madhe e Evropës po shkon drejt rritjes.....



Europa 5 Shtator Scan TV

### [Karburantet çmime rekord, pavarësisht naftës bruto/ Në Europë kostot ndikohen nga kapacitetet e rafinimit](#)

Perspektiva e paqes midis Iranit dhe SHBA-së i ka çuar çmimet e naftës ndjeshëm lart e poshtë në muajt e fundit. Nafta e papërpunuar Brent, standardi.....



Bota 5 Shtator Scan TV

### [TikTok sjell komente me zë/ Përdoruesit do të mund të reagojnë me audio dhe të ndajnë më shumë foto](#)

Seksioni i komenteve në TikTok do të bëhet shumë më kaotik. Platforma po ofron një sërë mënyrash të reja për të bashkëvepruar nën video, duke përfshirë.....

## Video





Video 14:02 - 5 Shtator 2026

[Edicioni i Lajmeve me Ada Hazizollin, ora 15:00, datë 5 Shtator 2026](#)



Video 18:06 - 4 Shtator 2026

[Edicioni i Lajmeve me Zhuljeta Kokën, ora 19:00, datë 4 Shtator 2026](#)



Video 16:04 - 4 Shtator 2026

[Edicioni i Lajmeve me Ada Hazizollin, ora 15:00, datë 4 Shtator 2026](#)



Video 12:12 - 4 Shtator 2026

[Volkswagen do të shkurtojë 100,000 vende pune - Ristrukturimi më i madh i ndodhur ndonjëherë...](#)



Video 11:11 - 4 Shtator 2026

[Edicioni Informativ me Ernilda Luzin, ora 12:00- 04.09.2026](#)



Video 08:08 - 4 Shtator 2026

[Edicioni i Lajmeve me Ervin Postolin, ora 09:00, datë 04 Shtator 2026](#)



Video 17:05 - 3 Shtator 2026

[Edicioni i Lajmeve me Zhuljeta Kokën, ora 19:00, datë 3 Shtator 2026](#)



Video 16:04 - 3 Shtator 2026

[Edicioni i Lajmeve me Ada Hazizollin, ora 15:00, datë 3 Shtator 2026](#)



- [Lajme](#)
- [Scan Intel](#)
- [Analiza](#)
- [Dossier](#)
- [Scan Life](#)
- [Emisionet](#)

Scan është një media online e pavarur. Përpjekja jonë është të sjellim lajme, analiza dhe komente, në shërbim të interesit publik.

NIPT: K12312001A

Created and monetized by mediadesk

- [Kontakt](#)
- [Të drejtat e përdorimit](#)
- [Cookies](#)

Regjistron emailin tënd në New

ME SHTO

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.